

19.05.2020

CCPS COVID-19 Udhëzime për rikthimin në shkollë

Masat në shkollë për shëndetin dhe sigurinë

- Komiteti Qendror i Mbrotjes së Shëndetit të Australisë (AHPPC) ka këshilluar që “rregulli i grupimeve nëpër ambiente” prej më shumë se një person për metër katror nuk është i përshtatshëm dhe as praktik nëpër klasa ose korridore, ashtu sikurse ruajtja e distancës prej 1.5 metra midis nxënësve gjatë aktiviteteve shkollore nëpër klasa. Rrjedhimisht, rregulli i përcaktuar për 10 studentë në klasë nuk është më i detyrueshëm nëpër shkolla.
- Për të mbështetur personelin e shkollave në përgatitjet për fazën tranzitore, **dita e hënë, pra data 25 maj 2020 do të jetë ditë e lirë për nxënësit**. Shkollat do të shfrytëzojnë këtë ditë për t’u dhënë nxënësve këshilla mjekësore që duhen ndjekur në shkollë, për të ri-përcaktuar praktikat shkollore, për të përcaktuar një qasje të vlerësimit të progresit të nxënies gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin në distancë dhe në mënyrë fleksibël, si dhe për të identifikuar ata nxënës që kanë nevojë të menjëhershme për ndihmë lidhur me shëndetin dhe mirëqenien.
- Ne e vlerësojmë rëndësinë e suportit ndaj nxënësve për t’i ndihmuar ata të rikthehen në proces normale shkollore, duke u ndërgjegjësuar për situatën, duke ofruar informacion të përshtatshëm zhvillues mbi çfarë po ndodh dhe për të ofruar një ambient ku nxënësit ndjehen të sigurt për të ngritur shqetësime e për të shprehur ndjenjat e tyre.

Të gjithë nxënësit e klasave më të larta që rikthehen në shkollë duhet të frekuentojnë mësimin. Shkollat nuk do të ofrojnë mësim në distancë në rastet kur prindërit zgjedhin t’i mbajnë fëmijët e tyre në shtëpi, me përjashtim të rasteve kur ky vendim bazohet në këshilla mjekësore. Në raste të tilla, lutemi të kontaktoni Zëvendës Drejtorin e Shërbimit Nën shkollor.

Formimi - Klasa e 2-të: Anne McDonald
Klasa e 3-të deri në klasën e 6-të Mick Sweeney
Mirëqenia: Kerry Bates

Masa të tjera për shëndetin dhe sigurinë

- Mund të përdoren mjetet në ambientet e lojërave. Megjithatë nxënësit do të praktikojnë procedurat e higjienës së duarve përpara dhe pas përdorimit. Ambientet e lojërave do të pastrohen pas pushimit dhe gjatë pushimit të drekës me dezinfektues të tipit spitalor, si pjesë e programit të përmirësuar të pastrimit.
- Në rast të përdorimit të mjeteve të përbashkëta, do të aplikohet procedurë shumë e rreptë e higjienës së duarve përpara dhe pas përdorimit.
- Nxënësit duhet të sjellin shishen e tyre të ujit për përdorim në shkollë, pasi nuk do të lejohen të pinë direkt nga çezmat e ujit të pijshëm.

- *Politika e përdorimit të telefonave celularë nga nxënësit* DET mbetet ende në zbatim. Nxënësve do t'u kërkohet të pastrojnë telefonat e tyre celularë me një shami letre me dezinfektues gjatë kohës së dorëzimit të tyre tek zyra përkatëse çdo mëngjes. Telefonat mund të ndizen me aplikacionin COVID SAFE të aktivizuar përpara dhe pas mësimit në shkollë. Shkollat janë ambiente të menaxhuara që përfshijnë regjistra të nxënësve, personelit dhe pranisë fizike të vizitorëve, të cilët mund të ndihmojnë lidhur me gjurmimin e kontakteve.

Shëndeti mendor dhe mirëqenia

Në rast se keni shqetësime specifike lidhur me shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijës tuaj, ju lutemi të njoftoni Zëvendës Drejtorët në mundësinë më të parë, me qëllim që të garantohet çdo shërbim dhe ndihmë në dispozicion.

Formimi - Klasa e 2-të: Anne McDonald

Klasa e 3-të deri në klasën e 6-të Mick Sweeney

Mirëqenia: Kerry Bates

Pastrimi

Në shkollë janë prezantuar masa organizative për pastrim të përmirësuar dhe të shtuar dhe kjo praktikë do të vijojë. Këtu përfshihet pastrimi progresin gjatë ditës, për të garantuar që rreziku i transmetimit është reduktuar për sipërfaqet që preken shpesh.

Prezenca fizike në ambientet e shkollës

Një prej veprimeve të rëndësishme që mund të ndërmarrin shkollat komunitare për të reduktuar rrezikun e transmetimit të koronavirusit (COVID-19) është të sigurohen që personeli, fëmijët apo të rinjtë që ndjehen sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

Teksa rreziku i transmetimit të virusit është tepër i ulët, personeli ose nxënësit më të rrezikuar ndaj sëmundjeve të rënda duhet të vlerësohen individualisht për mundësinë e pranisë fizike në ambientet shkollore.

Duke pasur parasysh se rreziku kryesor i transmetimit të koronavirusit (COVID-19) në ambientet shkollore ekziston midis personave të rritur, numri i vizitorëve në ambientet shkollore do të kufizohet vetëm për ata që ofrojnë shërbime furnizimi për shkollën dhe për ata që ofrojnë shërbime shkollore ndihmëse që janë të nevojshme. Nëse prindërit duhet të kontaktojnë shkollën për çfarëdo arsye, janë të lutur të telefonojnë zyrën e shkollës.

Personeli dhe studentët që nuk ndjehen mirë duhet të qëndrojnë në shtëpi.

Prindërit/kujdestarët e nxënësve me nevoja mjekësore komplekse (duke përfshirë dhe rastet e problemeve të sistemit të dobët imunitar) duhet të konsultohen me mjekun e nxënësve për të ndihmuar në marrjen e një vendimi për përshtatshmërinë e ambientit shkollor për prani fizike, duke pasur parasysh faktin se rekomandimi mjekësor në fjalë mund të ndryshojë në varësi të situatës së pandemisë së koronavirusit (COVID-19) në Viktoria. Sa më sipër është në linjë me politikën e [Nevojave t! Kujdesit Shëndetësor DET](#) . Në këtë drejtim, shkolla do të ndihmojë çdo familje në nevojë për asistencë shtesë.

Këshillet shkollore, ekskursionet, kampet dhe grumbullimet e mëdha jo esenciale shtyhen deri në një njoftim të ri.

Higjiena

Gjithkush mund të mbrohet dhe të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së koronavirusit (COVID-19) duke ruajtur një higjienë efektive të duarve. Masat e përmirësuara të higjienës do të vazhdojnë gjatë rikthimit në praktikën e mësimdhënies nëpër shkolla.

- Personeli dhe nxënësit do të ndjekin procedura të rregullta të higjienës së duarve, veçanërisht kur vijnë në shkollë, përpara dhe pas vakteve, pas pastrimit të hundëve, kollitjes, teshtitjes dhe përdorimit të tualetit. Kjo do të kryhet nën orientimet ose kujdesin e personelit, kur kërkohet.
- Në rastet kur nuk disponohet sapun dhe ujë, do të përdoren dezinfektantët që do të vendosen në çdo sallë.
- Në këtë periudhë nxënësit nuk do të lejohen të pijnë ujë direkt nga çezmat e ujit të pijshëm. Për këtë arsye ata duhe të kenë me vete shishen e tyre të ujit për përdorim (dhe mbushje) në shkollë.

Ardhja dhe largimi nga shkolla

Meqenëse rreziku kryesor i prekjes nga koronavirusi (COVID-19) në ambientet shkollore është nga të rriturit, duhet të shmangët afërsia e madhe midis personave të rritur të komunitetit të shkollës, veçanërisht gjatë mbërritjes në shkollë dhe marrjes në dorëzim të nxënësve.

- Personelit dhe prindërve u kërkohet të jenë të vëmendshëm ndaj zbatimit të masave të ruajtjes së distancës duke mos u grumbulluar në zona brenda ose përreth shkollës.
- Masat organizative për të praktikuar ruajtjen e distancës fizike dhe për të minimizuar ndërveprimin e nxënësve me personat e rritur brenda ambienteve të shkollës dhe tek pikat e hyrjes në të do të përfshijnë:
 - Vendosjen e pikave tek dera e shkollës për të inkurajuar hapësirën midis personave të rritur.
 - Ndalimin e qëndrimit të prindërve, të cilët mund të kontaktojnë shkollën me telefon ose e-mail, siç kërkohet.
 - Zhvillimin e takimeve esenciale me video konferencë.
 - Kryerjen e çdo ndërveprimi për të vërejtur zbatimin e udhëzimeve të ruajtjes së distancës sociale dhe përshëndetjet pa kontakt fizik.
 - Potencialisht orar të rreptë për të çuar fëmijët në shkollë dhe për t'i marrë ata, me qëllim reduktimin e numrit të personave të rritur tek dera e shkollës ose jashtë klasave, nëse nevojitet.